

AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR

“ADEK FRUCHT “ SHBB

Sot me date **07.07.2022** ne te nenshkruarit ne mbeshtetje te ligjit nr.38,date 05.04.2012 hartojme dhe nenshkruajme kete akt themelimi si anetare te shoqerise se bashkepunimit bujqesor :

1. **Z.Armelin Meta** , shtetas shqiptar, i datelindjes 26.06.1988, lindur dhe banues ne Fier i Ri , identifikuar nepermjet ID me numer **I80626021C** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
2. Znj. **Lorena Serjanaj** , shtetase shqiptare , e datelindjes 23/09/1984, lindur dhe banuese ne Vlore, mbajtese e leternjoftimit me nr. **034415648**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.
3. **Z. Dritan Serjanaj**, shtetas shqiptar, i datelindjes 23/04/1979, lindur dhe banues ne Vlore, mbajtes i leternjoftimit nr.**032681010**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
4. Znj.**Miserdhe Serjanaj** , shtetase shqiptare , e datelindjes 01.05.1953, lindur dhe banues ne Velçe , mbajtese e ID me nr. **F35501239F** , madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar.
5. **Z. Banush Serjanaj** , shtetas shqiptar, i datelindjes 20/02/1954, lindur dhe banues ne Lapardha , mbajtes i leternjoftimit me nr.**035655838** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
6. **Z. Erien Meçaj** , shtetas shqiptar, i datelindjes 25/01/1988, lindur dhe banues ne Vlore, mbajtes i ID me nr. **I80125115N**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
7. **Z. Kristian Musta** , shtetas shqiptar i datelindjes 25/01/1977, lindur dhe banues ne Vlore, mbajtes i leternjoftimit me nr.**031175444**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Kjo shoqeri eshte nje organizem i krijuar me vullnetin e lire te anetarve te saj,jo politike dhe e pavarur.

NENI 1


EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise do te jete Shoqeria e Bashkepunimit Bujqesor “ADEK FRUCHT” SHBB .

Neni 2

QELLIMI DHE OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete objektin si me poshte vijon:



- Prodhim te produkteve bujqesore (fruta perime ne fushe dhe ne sera) dhe shitjen e ketyre produkteve bujqësore të anëtarëve të saj tek tatimpagues që nuk janë pjesë e skemës së kompensimit ne menyre qe te perfitoje statusin e prodhuesit bujqësorë, për të cilët zbatohet regjimi i veçantë i skemës së kompensimit të fermerëve sipas VKM-se nr.953, datë 29.12.2014 .

-Permbushja e qellimeve dhe nevojave te antareve te vete Shoqerise;

-Rritjen e prodhimit bujqesor dhe blegtoral te fermerve ne treg;

-Promovimin e eksporteve;

-Konsolidimi i kanaleve te marketingut bujqesor;

-Institucionalizmi i bashkepunimit ne bujqesi;

-Reduktimi i efekteve negative te ndikimit te fermes se vogel ne Shqiperi;

-Zgjidhja e problemit te fermave te vogla dhe te pafuqishme financiarisht;

-Zvogelimi i aktiviteteve informale;

-Perfitimin e granteve qeveritare dhe atyre ne bashkepunim nga nje numer sa me i madh fermeresh;

Shoqeria nuk do te ndjeke qellime politike.Ajo eshte nje Shoqeri qe ka ne thelb mbrojtejen e interesave te fermereve dhe rritjen e cilesise se sherbimeve qe ju ofrohen vete fermereve per te nxjerre ne fund nje produkt sa me cilesor dhe me kosto te perballueshme ne treg.

Per zhvillimin sa me te mire te ketij objekti fermeret vete vendosin te organizohen ne shoqeri qe do te ofrojne sherbime te caktuara nga te cilet do te perfitojne po keta fermere.Ne thelb te kesaj Shoqerie do te jete permbushja e nevojave te antarit te saj.Kjo Shoqeri do te shfrytetoje ekonomite e shkalles duke ulur kostot per njesi per blerjen e lendeve te para,te fuqise puntore,te investimeve si dhe sigurimit te shitjes apo shperndarjes se prodhimit te tyre.

NENI 3


QENDRA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISE

Qendra e Shoqerise do te jete ne adresen: Fier, Lushnje, Krutje e poshtme, parcela me numer pasurie 115 dhe zone kadastrale 175/12 .

Veprimtaria e saj do te shtrihet ne rajonin e Lushnjes si dhe kudo ku shtrihet antaresia e saj.

NENI 4-KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "ADEK FRUCHT" SHBB eshte e pakufizuar.



NENI 5

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ANETARIT

Cdo anetar ka te drejte te shfaqe mendimet e tij, te diskutoje ne mbledhje, te kerkoje llogari per harxhimin e fondeve, te kundershtoj ne Gjykatën Kompetente vendimet e shoqerise qe vijne ne kundershitim me ligjin dhe statutin brenda nje muaji nga dita qe ka marre njoftimin per ate vendim.

Gjithashtu cdo anetar ka per detyre te zbatoje me rigorozitet dispozitat ligjin ne fuqi dhe statutin e shoqates, si dhe te derdhe kontributet nje here ne vit ne daten e caktuar ne kapitalin e shoqerise. Organi me i larte i shoqerise eshte Mbledhja e Pergjithshme e anetareve.

Mbledhja e pergjithshme vendos per pranimin ose perjashtimin e anetareve.

Miraton programin vjetor te masave dhe detyrave qe do te realizje shoqeria per realizimin e objektit te parashikuar ne kete statut.

Mbledhja e pergjithshme zgjedh ose shkarkon Administratorin e Shoqerise me votim te fshehte.

Te gjithë anetaret e Shoqerise kane te drejte vote te barabarte ne mbledhjen e pergjithshme. Anetaret e Shoqerise kane te drejte te lirisht ne cdo kohe nga Shoqeria me kerkese drejtuar Administratorit.


Vendimet merren me shumicen e votave te anetarve qe jane te pranishem ne mbledhje. Per ndrushimin e statutit, per perjashtimin e nje anetari dhe per shperndarjen e shoqates duhet te jene pra te pakten shumica e te gjithë anetarve te shoqerise.

Anetaret e Shoqerise kane te drejte te propozojne ndrushime ne organiken dhe rregullat e Shoqerise.

Anetaret kane te drejte te informohen ne cdo kohe mbi mbarevajtjen e aktivitetit te Shoqerise, te marrin pjese ne aktivitet promovuese te Shoqerise, te ruajne konfidencialitetin si dhe te paguajne kontributet e detyrueshme.

Anetaret kane te drejte te informohen ne cdo kohe mbi mbarevajtjen e aktivitetit te Shoqerise, te marrin pjese ne aktivitetet promovuese te Shoqerise, te ruajne konfidencialitetin si dhe te paguajne kontributet e detyrueshme.

Anetaret kane te drejte te propozojne ndrushimin e administratorit te shoqerise, te informohen per llogarite vjetore financiare, per raportet e eksperteve kontabel, menytrat dhe procedurat ndarjes se fitimit, raportin e veprimtarise se shoqerise si dhe cdo te drejte apo detyrim tjeter qe eshte e parashikuar ne Ligj.



NENI 6

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne vlere ne shumen **9.520.000** (nente milione e peseqind e njezete mije) Lek.

Kapitali mund te derdhet me para ne dore ose ne kontributin ne natyre (objekte, toke ose makineri.

Kontributet ne natyre shprehen ne vlere ekonomike mbi bazen e nje raporti vleresimi te bere nga nje ekspert i caktuar nga Asambleja e Antareve.


Anetaret jane pronare te asetëve te tyre ne kapitalin e shoqerise duke qene keshtu dhe pronare te Shoqerise ne raport me kontributet ne kapital.

Kapitali perkates mund te shitet, dhurohet apo lihet ne trashegimi nga secili prej antareve te Shoqerise.

Ne momentin e krijimit te Shoqerise kapitali fillestar eshte i ndare ne 4 (kater) kuota te barabarta ne vleren **1.904.000** (nji milion e nenteqind e kater mije leke) ose **20%** secila kuote, **1** (nji) kuote ne vleren **952.000** (nenteqind e pesedhete e dy mije) leke ose **10%** e kapitalit dhe **2** (dy) kuota te barabarta ne vleren **476.000** (katerqind e shtatedhete e gjashte mije) leke ose **5%** e kapitalit e cila zoterohet si me poshte percaktuar;

1. **Z. Armelin Meta** zoteron nje kuote ne shumen **1 904 000** (nji milion e nenteqind e kater mije) leke qe perben **20 %** te kapitalit fillestar.
2. **Z. Lorena Serjanaj** zoteron nje kuote ne shumen **1 904 000** (nji milion e nenteqind e kater mije) leke qe perben **20 %** te kapitalit fillestar.
3. **Z. Dritan Serjanaj** zoteron nje kuote ne shumen **1 904 000** (nji milion e nenteqind e kater mije) leke qe perben **20 %** te kapitalit fillestar.
4. **Z. Erien Meçaj** zoteron nje kuote ne shumen **1 904 000** (nji milion e nenteqind e kater mije) leke qe perben **20 %** te kapitalit fillestar.
5. **Z. Kristian Musta** zoteron nje kuote ne shumen **952 000** (nenteqinde e pesedhete e dy mije) leke qe perben **10 %** te kapitalit fillestar.
6. **Z. Banush Serjanaj** zoteron nje kuote ne shumen **476 000** (katerqind e shtatedhete e gjashte mije) leke qe perben **5 %** te kapitalit fillestar.
7. **Z. Miserdhe Serjanaj** zoteron nje kuote ne shumen **476 000** (katerqind e shtatedhete e gjashte mije) leke qe perben **5 %** te kapitalit fillestar.

TOTALI= 9 520 000 (nente million e peseqinde e njezete mije) leke ose 100%



NENI 7

ORGANET DREJTUSESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese te shoqerise jane:

1.Asambleja e Pergjithshme e Antareve

2.Administratori i cili me vendim te Asamblese mund te qendroje ne detyre per nje periudhe kohe maksimale jo me shume se 5 vjet.

3.Administrator i miratuar nga mbledhja themeluese e Shoqerise emerohet Z. **Armelin Meta** , shtetas shqiptar, i datlindjes 26.06.1988, lindur dhe banues ne Fier i Ri , identifikuar nepermjet ID me numer **I80626021C** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili emerohet administrator per nje periudhe **5 vjecare**.

Administrator ngarkohet me kryerjen e te gjitha procedurave te regjistrimit te Shoqerise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 8

MENYRA E SHPERNDARJES SE SHOQERISE

Shoqeria shperndahet me vendim te mbledhjes se pergjithshme te thirrur nga Administratori.

Procedura e ndjekur per shperndarjen e saj percaktohet ne Statutin e Shoqerise.

Shoqeria shperndahet ne keto raste;

-Kur numri i anetarve eshte nen shtate veta.

-Kur qellimi i saj eshte permbushur apo nuk ka mundesi te permbushet ka humbur aftesi paguese.


Ne rast shperndarjeje te shoqerise ajo pushon veprimtarine e saj dhe vihet ne likuidim nga komisioni i likuidimit i cili formohet sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise ne QKR.Ne kete dite shoqeria njihet edhe si person juridik.Te drejten e perfaqsimit ne gjykate te shoqates per te bere regjistrimin e saj e ka Administratori i saj ose nje person i autorizuar prej tij.




PERFAQSIA THEMELUESE

ARMELIN META



LORENA SERJANAJ



DRITAN SERJANAJ



ERIEN MECAJ



KRISTIAN MUSTA



BANUSH SERJANAJ



MISERDHE SERJANAJ

